



Pranuar / Dorezuar Primihero/Prodato Received / Delivery	14.04.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPnStK	3566/2023		113



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova  
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.637/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2332/21 të datës 10.03.2021 të pranuar me datë 14.03.2023, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.637/2021 të datës 13.07.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 14.04.2023, morri këtë:

V E N D I M

**PËRFUNDON** procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.637/2021 i datës 13.07.2021 i parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përmes listës për deklarinimin e statusit të zyrtarëve publik, duke u bazuar në Akt Emërimin me numër 0/79 të datës 06.03.2012 e ka përcaktuar ankuesin Berat Halili si nëpunës administrativ dhe mbështetës. Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik përmes shkresës zyrtare (email) me datë 12.11.2020 ka njoftuar Njësinë e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me përcaktimin e statusit të Zyrtarëve Publik. Ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 15.06.2021 përmes shkresës Zyrtare (email) ka njoftuar ankuesin lidhur me përcaktimin e statusit të tij si nëpunës administrativ dhe mbështetës.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 15.06.2021 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me përcaktimin e statusit të tij si nëpunës administrativ dhe mbështetës më datë 13.07.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit A.nr.637/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyes Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave më datë 16.07.2021, ka proceduar



kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ndërsa më datë 26.07.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyes Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje me datë 01.09.2021 ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtin që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Ankuesi, në mungesë të kuorumit për vendosje ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 10.03.2023 ka nxjerr Aktgjykim me numër A.nr.2332/21, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 13.07.2021 të parashtruar nga ankuesi.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Aktgjykimi me numër A.nr.2332 i datës 10.03.2023; Ankesën me numër protokoll 3684/2021 të datës 13.07.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raport me numër 02-46/1 i datës 20.01.2023; ID Kartela me numër 0096; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 21.01.2021; Dëshmi nga SIMBNj; Listë e pagës për muajin Shkurt 2021; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit i datës 06.11.2013; E-mail i datës 08.06.2021; E-mail i datës 06.05.2021; E-mail i datës 12.11.2020; E-mail i datës 15.06.2021; E-mail i datës 09.07.2021; Listë për përshkrimin e detyrave të punës e lëshuar nga MAPL; Qarkore Administrative Nr.01/2016 e datës 21.01.2016; Katalogun e vendeve të punës; Akt Emërim me numër Nr.0/79 i datës 06.03.2012; Kontratë e marrëdhënies së punës me numër 079/1 e datës 07.08.2006; Formulari për vlerësimin në punë i datës 21.12.2018; Formulari për vlerësimin në punë i datës 26.12.2018; Vendim me numër Nr.111-160-2 i datës 01.03.2021; Kërkesa për pushim e datës 20.11.2019; Kërkesa për pushim e datës 28.01.2020; Listë e deklarimit të Zyrtarëve Publik; Përgjigje në kërkesë e datës 26.07.2021; Fletkthesë e datës 09.09.2021; Fletkthesë e datës 21.07.2021; Provat shtesë të parashtruara nga ankuesi të datës 02.08.2021; Shkresë me numër protokoll Nr. 4142 e datës 14.09.2015; Shkresë me numër protokoll Nr.111-1347/1 e datës 06.11.2015; Aneks; Shkresë me numër protokoll Nr.111-1347 e datës 18.11.2015; Aneks; Listat me përshkrimin e detyrave të punës; Rregullore (QRK) NR.04/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal; Njoftim i datës 01.09.2021; Vendim me numër A.Nr.332/2022 i datës 19.05.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën me numër A.nr. 637/2021 të iniciuar nga ankuesi është bërë i pamundur, sepse:

Nga administrimi i provave të lartcekura Kolegji, ka gjetur se lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit i njëjti me datë 05.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll A.nr.332/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konkretisht për të njëjtën çështje, për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku rrjedhimisht Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit me numër A.nr.332/2022 më datë 19.05.2022, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit dhe duke e lënë në fuqi Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publik të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të darës 09.06.2021 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë si dhe Njoftimi i datës 15.06.2021 i Njësisë së Personelit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me deklarimin e statusit sipas Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji i Këshillit, mbi këtë bazë konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për procedurën e kontestuar nga ankuesi respektivisht ndaj njoftimit të datës 15.06.2021 të Njesisë së Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ka vendosur sipas Vendimit me numër A.nr.332/2022 më datë 19.05.2022, atëherë Kolegji duke u bazuar në rrethanat si me lartë, vlerëson se objekti i ankesës A.nr.637/2022 i datës 13.07.2021 është i njëjtë me objektin e ankesës së ankuesit të datës 05.04.2022, rrjedhimisht objekti i të dy ankesave bazohet në të njëjtën gjendje faktike dhe juridike, kështu që, Kolegji i Këshillit nisur nga ky konstatim dhe në kuptim të dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktik..*, konstatoi se janë përmbushur kushtet ligjore që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.637/2021/2022 të datës 13.07.2021 të parashtruar nga ankuesi Berat Halili, për shkak që për të njëjtën çështje është vendosur me vendim përfundimtar për më pak se dy vite.

Ashtu siç u tha me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** *Lënda me numër A.nr.637/2021*

**Kaltrina Avdullahi-Prenaj**

*[Signature]*  
Zyrtare e Lartë për bashkëpunim profesional

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

*[Signature]*  
Kryetare e Kolegjit



#### **Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Gjyqtarës Lirije Maksutaj në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; dhe
- Arkivit të KPMSHKCK-

